



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më	
Nr.	prot.

Data: 26.2.2025

Nr:209

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE PARTIA “ALEANCA ARBNORE KOMBËTARE”, ME KRYETAR Z. GJET NDOJ, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND, TË DATËS 11 MAJ 2025**

Sot, më datë 26.2.2025, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën nr. 1289 prot., datë 25.2.2025, me:

- KËRKUES:** Partia politike Partia “Aleanca Arbnore Kombëtare”, me kryetar Z. Gjet Ndoj
- OBJEKTI:** Regjistrimi i partisë politike Partia “Aleanca Arbnore Kombëtare”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025
- BAZA LIGJORE:** Neni 64, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

Partia “Aleanca Arbnore Kombëtare”, nëpërmjet Kryetarit, Z. Gjet Ndoj, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend, që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Data: 26.2.2025 Nr: 209  
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike Partia “Aleanca Arbnore Kombëtare”, me Kryetar Z. Gjet Ndoj, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 25.2.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Partia “Aleanca Arbnore Kombëtare”, me iniale “AAK”, me Kryetar Z. Gjet Ndoj, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02)
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03)

Nga dokumentacioni si më sipër dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është: Partia “Aleanca Arbnore Kombëtare”, me shkronja nistore “AAK”, me adresë: Rruga "Besa", nr. 55, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është: Z. Gjet Ndoj, me adresë: Rruga "Besa", nr. 55, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është: Z. Arlind Kafeja, me adresë: Stadiumi Dinamo, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në, është Z. Anton Ndoj, me adresë: Rruga "Besa", nr. 55, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga Partia “Aleanca Demokratike Shqipëtare”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga Partia “Aleanca Demokratike Shqipëtare” është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.1.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 11 Maj 2025.

## V E N D O S :

1. Regjistrimin e partisë politike Partia “Aleanca Arbnore Kombëtare”, me kryetar Z. Gjet Ndoj, me shkronjat nistore “AAK”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**